



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE

---

Nr. AKTI 1149

DATE 19.03.2018

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e përbërë prej:

Gjyqtare: Tereza Lani (Merkaj)

Asistuar nga sekretarja Elisabeta Tusha, sot më datë 19.03.2018, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqesor Tirane të perfaqësuar nga prokurori Endrit Bimi, ankimin që i perket:

KERKUES/ANKUES: Shërbimi përmbarimor ... sh.p.k, regjistruar në Q.K.B më datë 10.09.2010, Me NUIS L0., me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr..., Blv. "...", Rruga: "...", Nr..., Qendra e Biznesit "...", e përfaqësuar në gjykim nga Av.Alda Abazi me Autorizim të administratorit të Shoqërisë.

Objekti: 1. Shfuqizimi i Vendimit të sekuestrimit të datës 24.01.2018 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqesor Tiranë, lidhur me procedimin penal Nr.3986 të vitit 2016 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për çështjen përmbarimore në zbatim të Vendimit Nr... Akti, datë 26.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

2. Kthimin e sendeve të sekuestruara sipas Procesverbalit “Për sekuestrimin e dokumenteve” datë 26.01.2018 për të mos penguar dhe vazhduar më tej veprimet përmbarimore, duke përfshirë dosjen përmbarimore së bashku me vendimin gjyqësor/urdhërin e ekzekutimit.

Baza Ligjore:

Nenet 212 e vijues të K.Pr.Penale.

Gjykata, si verifikoi kryesisht kompetencen per shqyrtimin e kësaj kerkese penale, pasi administroi provat e paraqitura ne gjykim, pasi u njoh me çeshtjen ne teresi, ne pretendimet perfundimtare te paleve degjoi perfaqesuesen e pales kerkuese ankuesin i cili kerkoi pranimin e ankimit sipas sipas objektit si dhe pasi degjoi prokurorin i cila u shpreh per rrezimin e ankimit si te pabazuar ne ligj dhe ne prova,

## V E R E N

Se pala ankuese Shërbimi përmbarimor “...” sh.p.k i eshte drejtuar Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane me ankimin objekt gjykimi duke kontestuar ne thelb Vendimin e sekuestrimit te datës 24.01.2018 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me procedimin penal Nr.3986 të vitit 2016 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për çështjen përmbarimore në zbatim të vendimit Nr.577 Akti, datë 26.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe duke kerkuar shfuqizimin e ketij vendimi dhe kthimin e sendeve të sekuestruara sipas Procesverbalit “Për sekuestrimin e dokumenteve” datë 26.01.2018 te dosjes përmbarimore së bashku me vendimin gjyqësor/urdhërin e ekzekutimit.

Nga shqyrtimi gjyqesor i çeshtjes ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë bazuar ne kallezimin penal te shtetasit V.. K.. ndaj shtetasit A.. M.. ne cilesine e administratorit te shoqerise permbarimore ... sh.p.k , ka rregjistruar procedimin penal Nr.3986 të vitit 2016.

Ne funksion te hetimit lidhur me kete procedim pranë ankuesit Shërbimi përmbarimor ... sh.p.k, për nevoja të hetimit paraprak në funksion të procedimit penal Nr.3986 të vitit 2016 është disponuar nder te tjera nga organi i Prokurorisë Vendimi i Sekuestrimit të dokumentave, i datës 24.01.2018. Ky vendim është ekzekutuar më datë 26.01.2018, nga oficeri i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në zbatim të neneve 208/1, 300, 301/1 dhe 303/2 gërma “ç” duke u mbajtur edhe Procesverbali përkatës në ambientet e Qendrës së Biznesit ..., Blv. ..., në prezencë të Av.Afrovidhiti Shehu, në cilësinë e avokates së Shërbimit përmbarimor ... shpk. Sipas këtij procesverbali ndër të tjera janë sekuestruar edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

“1. kërkesa e kreditorit Banka e Tiranës sh.a datë 06.10.2011 Nr.prot ....

2. Urdhër ekzekutimi Vendim Nr.... Akti, datë 26.05.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, origjinal.

3. Titull ekzekutiv kontratë huaje afat gjate Nr.1... Nr.... Kol Nr.... Rep, datë 03.06.2005.... “

Procesverbali mbyllet më nr.rendor 92, që është edhe numri i dokumentave të sekuestruara pranë Shërbimit përmbarimor ... shpk.

Ne seance gjyqësore, gjate shqyrtimit gjyqesor te çeshtjes, perfaqesuesja e pales ankuese kerkoi nga Gjykata anullimin e vendimit si dhe kthimin e Urdhërit të ekzekutimit dhe të gjithë dosjes përmbarimore, duke pretenduar se janë sekuestruar nga Prokuroria në kundërshtim me nenet 513/1, 609 dhe 610 të K.Pr.Civile sipas të cilave mund të lëshohet vetëm një kopje urdhëri ekzekutimi dhe vetëm Gjykata mund të pezullojë veprimet përmbarimore. Po ashtu u pretendua se bazuar në nenet 213/1 dhe 208/1 të K.Pr.Penale organi procedues mund të mbaje kopje të akteve duke kthyer origjinalet dhe se ka pasaktësi në vendimin e sekuestrimit se për vërtetimin e cilave fakte është i nevojshëm

sekuestrimi. Gjithashtu sipas perfaqesueses pretendimet e kallëzuesit palë debitore janë shqyrtuar nga gjykata civile e cila nuk ka vlerësuar se veprimet përbarimore janë në kundërshtim me ligjin.

Ndërsa prokurori në seance gjyqësore kerkoi rrezimin e ankimit duke parashtruar se sipas neneve 208 dhe 217 dhe dispozitave vijuese të K.Pr.Penale dokumentet e sekuestruara janë akte origjinale të cilat përdoren me qëllim prove, i nevojiten origjinalet për qëllime të hetimit dhe nëse lejohet kthimi i provës do të shtoheshin pasojat e veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

Arsyetimi i Gjykates, argumentat juridike, interpretimi i dispozitave referuese proceduriale penale, analiza e provave dhe konkluzionet e Gjykates.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara këtyre pretendimeve në gjykim, pasi shqyrtoi në themel bazueshmerine e tyre në raport me aktet provuese të paraqitura në seance gjyqësore, Gjykata çmon se kërkesa e pales kerkuese Shërbimi përbarimor ... sh.p.k është e pabazuar në ligj dhe si e tille duhet të rrezohet.

Se pari, kjo Gjykate është kompetente për shqyrtimin e kesaj çështjeje, në respektim të nenit 212 të K.Pr.Penale “Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit” ku përcaktohet shprehimisht se:

“I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë në kërkimit të tyre, mund të bëjë ankim në Gjykatë...”

Në rastin konkret, ndodhemi para ankimit kundër vendimit të “Sekuestrimit” datë 24.01.2018 të prokurorit Endrit Bini, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sekuestrimin e dokumenteve pranë Shërbimit përbarimor ... shpk, i cili është subjekti ku janë sekuestruar sendet në kuptim të nenit 212/1 të K.Pr.Penale dhe shqyrtimi gjyqësor i kesaj çështjeje është kompetence e kesaj Gjykate në referim të dispozites proceduriale penale të sipercituar, pasi dhe procedimi penal Nr.3986 i vitit 2016 në funksion të te cilit është kryer ky veprim procedural është në kompetence hetimi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Se dyti, në nenin 208 të K.Pr.Penale “Objekti i sekuestrimit” përcaktohet shprehimisht se:

“1. Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. 2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. 3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit.

Me tej në nenin 187 të K.Pr.Penale jepet kuptimi i provës materiale si vijon: “1. Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes.”

Në keto kushte, Gjykata çmon se sekuestrimi i dokumentacionit të dosjes përbarimore konkrete pranë Shërbimit përbarimor ... sh.p.k është i ligjshëm dhe në përputhje me nenet 208 dhe 187 të K.Pr.Penale pasi ky dokumentacion përben provë materiale, është me rëndësi për ecurinë e hetimit apo veprimeve hetimore e proceduriale të nevojshme për t'u kryer në funksion të procedimit penal Nr.3986 të vitit 2016 dhe janë thelbësore në

sqarimin e rrethanave të çështjes lidhur me veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës“ të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në rastin objekt gjykimi Prokuroria po kryen hetime lidhur me procedimin penal Nr.3986 të vitit 2016 lidhur me shpërdorimin e detyrës nga përmbartuesi i Shërbimit përmbartimor ... shpk, dhe për nevoja të hetimit penal sekuestrimi i praktikës përmbartimore objekt gjykimi është i domosdoshëm për sqarimin e rrethanave të çështjes.

Gjithashtu, nisur dhe nga objekti i kësaj vepre penale, që mbron jo vetëm marrëdhëniet juridike që garantojnë veprimtarinë e rregullt ligjore të organeve shtetërore dhe atyre publike por edhe interesat dhe të drejtat e ligjshme të shtetit, shtetasve dhe personave juridike, Gjykata vlereson se kthimi i mundshëm i Urdhërit origjinal të ekzekutimit të Vendimit Nr.... Akti, datë 26.05.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjithë praktikës së përmbartimit për të cilën po zhvillohet procedimi penal Nr.3986 të vitit 2016, do të kishte ndikim në pasojat e veprës penale të shpërdorimit të detyrës nga përmbartuesit, të cilat mund të shtoheshin dhe në eventualitet të rëndoheshin më tej pasi nuk do të kishte pengesë për vijimin e procedurës së ekzekutimit nga Shërbimi përmbartimor ....

Sa më sipër, në rastin objekt gjykimi nuk është i aplikueshëm neni 213/1 i K.Pr.Penale “Kopjet e dokumenteve të sekuestruara” ku parashikohet se: “1. Organi procedues mund të urdhërojë nxjerrjen e kopjeve të akteve dhe të dokumenteve të sekuestruara, duke kthyer origjinalet dhe kur origjinalet duhet të mbahen urdhëron sekretarinë të lëshojë kopje të vërtetuar”, për shkak se mbajtja e dosjes origjinale lidhur me veprimet përmbartimore është e domosdoshme për të shmangur rëndimin e pasojave të veprës penale të “shpërdorimit të detyrës” si edhe për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore siç mund të jone p.sh. ekspertimi etj.

Për më tepër vetë organi procedues në një kohe të mëvonshme, kur të cmojë se nuk është më e nevojshme mbajtja e sekuestrës për qëllime prove, mund të vendosë që sendet e sekuestruara t’i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar, bazuar në nenin 217 të K.Pr.Penale ku parashikohet se: “1. Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestrës për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyer”.

Per keto arsye, Gjykata i vlereson ligjerisht të pabazuara pretendimet e pales kerkuese, duke konkluduar se kjo kerkese penale duhet rrëzuar.

#### PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 208 e vijues, 379, 383 të K.Pr.Penale,

#### V E N D O S I

Rrezimin e kerkeses Nr.1149 Akti date 31.01.2018 si të pabazuar në prova dhe në ligj. Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të pales kerkuese.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

U shpall në Tiranë sot më datë 19.03.2018.

SEKRETARE  
ELISABETA TUSHA

GJYQTARE  
TEREZA LANI (MERKAJ)